



Prishtinë, 20 dhjetor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1080\_2018

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Bilanceve të Energjisë; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohtorja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 12 nëntor 2018, për miratimin e dokumentit: Bilanci Afatgjatë të Energjisë Termike 2019-2028.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018, nxori këtë:

## VENDIM

- I. APROVOHET BILANCI AFATGJATË I ENERGISË TERMIKE për periudhën 2019-2028 i NQ Termokos sh.a.**

### Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike për periudhën 2019-2028 nga NQ Termokos sh.a. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
  2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2019-2028" të dorëzuar nga NQ Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE - së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike 2019-2029" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III.** Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në Bilanc.



IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.

VI. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, Anëtar

Izet Rushiti, Anëtar

Selman Hoti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike – 2019-2028, NQ Termokos

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së